



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900053/10

Tiranë ____/____/2019

Lënda: Rekomandohet "Përmirësimi i punës për rritjen e përgjegjësisë nga punonjësit e Policisë së Shtetit me qëllim sjelljen korrekte dhe profesionale ndaj protestuesve studentë apo qytetarëve të organizuar në protesta paqësore"

Drejtuar : KOMISARIATIT TË POLICISË NR.1
Z.Olti Agolli

Tiranë

KOMISARIATIT TË POLICISË NR.6
Z. Ardit Elmazi

Tiranë

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETITIT
Drejtorit të Përgjithshëm
Drejtues Madhor, Ardi Veliu

Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Drejtues i Parë Rebani Jaupi

Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

Sikurse jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit për realizimin e misionit të tij në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore dhe interesave të ligjshme të shtetasve ndaj veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të organeve të administratës publike, në veprimtarinë e punës së tij ka filluar me iniciativë apo mbi bazën e ankesave të qytetarëve raste kur ka pretendime të ndryshme për veprime të padrejta, ndaj organit të Policisë së Shtetit.

Këto problematika janë konstatuar kryesisht dhe gjatë monitorimit të protestave paqësore të organizuara nga grupe të ndryshme si studentët apo banorët tek “Unaza e Re” Tiranë.

Konstatimet tona pas trajtimit të këtyre dy rasteve po ju a paraqesim si më poshtë:

Rasti 1. Më datë 11.01.2019, Avokati i Popullit ka filluar me iniciativë rastin e bërë publik në media, dhe konkretisht në shkrimin tek Shqiptarja.com “*Studenti përplasët me efektivin e policisë tek Ekonomiku*” e shoqëruar dhe me video. Avokati i Popullit i shqetësuar për këtë qasje ndaj protestave studentore, ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ.

Jemi informuar se pas ngjarjes, studentët e Fakultetit Ekonomik E. K. dhe K. D. kanë paraqitur kallëzim penal në SHÇBA-në e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për veprime të padrejta të punonjësve të policisë së Komisarariatit të Policisë nr.1. Shërbimi i Çështjeve të Brëndshme dhe Ankesave pasi ka kryer veprimet e nevojshme hetimore proceduriale, më datë 16.01.2019, me shkresën nr.24 prot., materialin kallëzues e ka referuar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Komisariati i Policisë Nr.1 Tiranë, ka informuar institucionin e Avokatit të Popullit se :

“...Nga ana e jonë është shkuar në Fakultetin Ekonomik, më datë 11.01.2019, mbi bazën e shkresës nr.120, datë 10.01.2019, të Universitetit të Tiranës, administratorit, S. D., ku shkruhej situatë e krijuar në Universitetin e Tiranës, në të cilin disa individë, po shkaktojnë anormalitet në procesin mësimor duke cënuar rendin dhe sigurinë për studentët dhe stafin akademik, duke mos i lejuar ata që të hynin në auditor. Nga ana e jonë është shkuar për të bërë të mundur hyrjen e personelit dhe të studentëve në këtë fakultet, pasi përveç shkresës së sipërpërmëndur kemi marrë shumë telefonata nga salla e komandimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ku në këtë fakultet kërkohej prania e forcave të policisë, pasi forcat e SH.P.S.F-ve, nuk ishte në gjëndje për të përballuar këtë situatë të krijuar në Fakultetin Ekonomik”.

“Mbi bazën e kallëzimit të shtetasve E. K. dhe K. D., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.834 për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Më datë 17.04.2019, pas përfundimit të hetimeve paraprake, është dërguar në gjykatë, kërkesa për pushimin e hetimeve të procedimit penal. Sipas organit të akuzës, “*në veprimet e punonjësve të policisë të komisarariatit nr.1 Tiranë, nuk vërehen të jenë konsumuar elementë të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, apo të ndonjë vepre tjetër penale. Kjo pasi ata kanë qënë në fakultet në përmbushje të rregullt të detyrës së dhënë për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor pas kërkesës së vetë fakultetit dhe në përmbushje të detyrave të dhëna nga eprorët e tyre. Në lidhje me përdorimin e forcës nga ana e tyre, konstatohet se nuk ka shpërpjestim të saj në veprimet e kryera ndaj tyre*”.

Jemi në dijeni, se gjyqtari i seancës paraprake nuk e ka miratuar kërkesën e prokurorit për pushimin e hetimeve, vendim i cili është ankimuar nga organi i Prokurorisë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Organi i Prokurorisë gjatë fazës së hetimit ka kryer dhe ekspertimet mjekoligjore për të verifikuar pretendimet e studentëve për dhunë fizike të ushtruar nga Policia e Shtetit. Kështu, në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr.38, datë 12.01.2019, thuhet se *“tek shtetasi K. D. u konstatua dërmishje në gishtin e unazës së dorës së djathtë, por ky dëmtim nuk hyn në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme në punë”*. Ndërsa, në aktin e ekspertimit mjeko ligjor nr.39 datë 12.01.2019, thuhet se *“tek shtetasi E. K. nuk u konstatuan dëmtime trupore”*.

Nga ana jonë më datë 14.01.2019, janë pyetur punonjësit e policisë së Komisarariatit nr.1 Tiranë, z.S. I. dhe z.F. A. Në deklaratimet e tyre punonjësit e policisë ndërmjet të tjerave kanë shpjeguar se, *ju kanë bërë thirrje studentëve për të liruar hyrjen në fakultet. Tre prej studentëve kanë hyrë me dhunë brenda mjedisëve dhe tentuan të pengonin punonjësit e policisë duke i sharë e shtyrë ata me qëllim që të largoheshin prej aty. Studentët e kanë çarë derën e hyrjes për ta hapur atë plotësisht, ndërsa punonjësit e policisë ju kanë bërë thirrje për t’u larguar duke i kapur nga duart apo dhe jaka e xhupit që mbanin veshur. Sipas punonjësve të policisë, ata nuk kanë përdorur dhunë fizike, por kanë vepruar në mënyrë korrekte dhe brenda kompetencave, edhe pse studentët i kanë shtyrë me forcë duke përdorur fjalë ofenduese”*.

Nga analiza e këtij rasti vlerësojmë se duket e panevojshme dhe e nxituar përplasja fizike e efektivit të policisë së Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë me studentin (e pasqyruar në video) e manifestuar me kapjen dhe përdredhjen e dorës së djathtë, dëmtim i konfirmuar dhe nga konkluzionet e aktit të ekspertimit mjekoligjor nr.38 datë 12.01.2019.

Po t’i referohemi nenit 133¹, pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, punonjësi i policisë e përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Ndërsa, në VKM Nr.750, datë 16.09.2015 *“Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”*, neni 110² parashikohet se punonjësi i policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm dhe në çdo rast, pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në këtë frymë, gjatë gjithë monitorimeve të protestave të studentëve, Avokati i Popullit ka bërë thirrje që askush të mos ushtronte asnjë lloj forme intimidimi apo presioni të fshehur ose të drejtpërdrejtë për të cenuar të drejtën e studentëve për të protestuar dhe për të zgjedhur një qasje të re e mirëkuptuese, dëgjuese dhe vetëkorrigjuese, përballë

¹ Neni 133 i Ligjit Nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*:

“1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.

2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

² Neni 110 i VKM Nr.750, datë 16.09.2015:

“1. Punonjësi i Policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.

2. Punonjësi i Policisë, në çdo rast e përdor forcën pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe përdor gjithmonë mjete të përshtatshme në proporcion me rrezikun dhe qëllimet që synohen të arrihen.

3. Punonjësi i Policisë është përgjegjës individualisht për ushtrimin e forcës dhe jep llogari para ligjit”.

kërkesave të tyre të drejta për plotësimin e disa pikave me synim përmirësimin e gjendjes së arsimit universitar në vend.

Gjithashtu, si institucion ne kemi mbajtur qendrimin se janë jo të pranueshme justifikimet se përdorimi i forcës për shpërndarjen e studentëve që kanë zgjedhur ta zhvillojnë protestën e tyre në ambientet universitare, bëhet për të garantuar zhvillimin normal të mësimin në ato ambiente.

Rasti 2. Më datë 23.07.2019, shtetasi M. F. nga Tirana, ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, pasi sipas tij më datë 22 Korrik 2019, rreth orës 20.45, në banesë kanë shkuar 5-6 punonjës policie civilë, të cilët kanë ushtruar dhunë fizike ndaj tij dhe djalit E. F. Më pas, punonjësit e policisë i kanë shoqëruar në Komisariat ku dhe kanë bërë arrestin në flagrancë të tyre, duke i akuzuar për veprën penale “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”.

Shtetasi M. F. ka pretenduar se ka ndërhyrë tek punonjësit e policisë që po dhunonin fizikisht djalin e tij E. F., për t’u sqaruar, por ata e kanë shtyrë me forcë duke e rrëzuar tek trotuari i rrugës dhe i shkaktuan dëmtime tek kavilja e këmbës së djathtë.

Mbi këtë shqetësim qytetar, është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në marrjen e shpjegimeve të ankuesit M. F. dhe marrjen e përgjigjeve të shkresave tona nga Drejtoria Vendore e Policisë dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Drejtoria vendore e Policisë ka informuar se shoqërimi dhe më pas arresti në flagrancë i shtetasve M. F. dhe E. F. është realizuar nga inspektorët e Patrullës së Përgjithshme të Seksionit të Forcës së Posaçme “Shqiponja” në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, më datë 22.07.2019 për kundërshtim të punonjësit të policisë gjatë protestës tek “Unaza e Re”.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 23.07.2019, ka regjistruar procedimin penal nr.5589 për kryerjen e veprës penale “*Kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit publik*”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, në ngarkim të personave nën hetim M. F. dhe E. F., ndaj të cilëve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1730 datë 25.07.2019, ka vendosur masë sigurimi “*Detyrim për Paraqitje në Policinë Gjyqësore*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se situatat e krijuara nga protestat e banorëve të Unazës së Re, mund të shmangeshin me një qasje më pajtuese, konsesuale dhe mirëkuptuese nga ana e autoriteteve shtetërore kundrejt komunitetit të qytetarëve që ndjeheshin të cënuar nga projekti i zgjerimit të Unazës së Re. Në mënyrë të përsëritur, është kërkuar që autoritetet të garantojnë me të gjitha mënyrat që qytetarët të shprehin pakënaqësitë e tyre në mënyrë paqësore, të pashqetësuar dhe të pa vënë nën presion të çdo lloji.

Veprimet e dhunshme gjatë shoqërimeve të protestuesve e referuar dhe nga shtetasit M. dhe E. F., është shqetësuese dhe bie ndesh me etikën e Policisë së Shtetit për të vepruar në përputhje me ligjin, me standartet më të larta profesionale dhe në respektim të dinnitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Janë konstatuar disa raste të moszbatimit të procedurave standarte gjatë kryerjes së veprimeve në ushtrimin e detyrës nga punonjësit e Policisë së Shtetit, si kur ndeshen më rezistencë fizike të shtetasve,

persona të dyshuar si autorë të kryerjes së veprës penale, ose shkelje administrative të ndryshme.

Në bazë të monitorimeve të ndihmëskomisionerëve të Avokatit të Popullit, janë jo të pakta rastet kur protestuesit janë *“arrestuar në flagrancë”*, për vepra penale të tilla si, *“Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”* ose *“Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”*, në disa raste rrjedhojë e veprimeve jo profesionale dhe në kapërcim të kompetencave të punonjësve të policisë.

Në raste të tjera në procesverbalin e arrestit të flagrancë pasqyrohen disa vepra penale shpesh stereotipe në qytetarë të ndryshëm, por që më pas organi i Prokurorisë i ka seleksionuar ato duke paraqitur vetëm një vepër penale ndaj personave nën hetim. Po ashtu raportet e shërbimit mbajtur nga punonjësit e policisë që kanë bërë shoqërim/arrestimin e personave, pa u kthyer në deklarime të personave është praktikë e gabuar e punës së Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit. Këto konstatime kanë dalë gjatë monitorimit të seancave gjyqësore nga ekspertët e Avokatit të Popullit.

Sugjerojmë që duhet të merren masat e menjëhershme për dhënien fund të praktikave të tilla, në çanim të të drejtave të qytetarëve. Nga ana tjetër duhet më tepër bashkëpunim i Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë me prokurorët e gatshëm në raste të ngjarjeve të tilla, për të pasqyruar në proces verbalet e arrestit në flagrancë veprën penale konkrete të kryer, bashkëlidhur provën shkencore që e përlligj, si video, fotografi etj.

Qytetarët e arrestuar nga Policia e Shtetit kanë protestuar për prishjen e banesave nga IKMT-ja, me pasoja të rënda sociale në jetën e tyre si përsa i përket banimit ashtu dhe punës, pasi jo në pak raste në ato godina ata ushtronin aktivitet privat. Arresti në flagrancë dhe më pas dënimi i tyre thellon më tepër problemet sociale të kësaj shtrese të dobët të shoqërisë tonë.

Çmojmë se sjellja korrekte, zbatimi rigoroz i dispozitave ligjore, etika policore dhe respektimi i standarteve profesionale nga punonjësit e Policisë së Shtetit shërbejnë për të siguruar qytetarin se dhënia e shërbimeve të policisë është e cilësisë më të lartë, ndaj ky rekomandim duhet të bëhet objekt i analizës së punës me strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit.

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të Policisë së Shtetit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek ky organ, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gjermën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

“Përmirësimin e punës për rritjen e përgjegjësisë nga punonjësit e Policisë së Shtetit me qëllim sjelljen korrekte dhe profesionale ndaj protestuesve studentë apo qytetarëve të organizuar në protesta paqësore”.

Mbi masat e marra dhe qëndrimin që do të mbani për rekomandimin, lutemi na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, me ndryshimet përkatëse.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermonela RUSPI